

LIGJ
Nr.8363, datë 1.7.1998

PËR KRIJIMIN E ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 " Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Për administrimin e buxhetit të gjykatave krijohet Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, e cila më poshtë do të quhet "Zyra".

Zyra është person juridik më vete, në varësi të gjykatave.

Shpenzimet e veprimtarisë së kësaj zyre përballohen nga buxheti i gjykatave.

Neni 2

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të gjykatave u nënshtrohet rregullave dhe procedurave ligjore për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë. Zyra administron fondet buxhetore të destinuar për gjykatat, duke siguruar zbatimin në parim të pavarësisë së tij nga pushtetet e tjera.

Neni 3

Zyra ka këto kompetenca kryesore:

a) Studion dhe përcakton nevojat për buxhet të të gjitha hallkave të gjykatave në bashkëpunim me sektorët financiarë të gjykatave të të gjitha niveleve.

b) Përpunon treguesit financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave.

c) Kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.

Neni 4

Fondet buxhetore në dispozicion të Zyrës përbëhen nga:

a) buxheti i miratuar me ligjin vjetor për Buxhetin e Shtetit, i ndarë për çdo nivel të gjykatave, i cili përfshin edhe ndihmat e dhëna nga institucionet vendase ose të huaja për gjykatat në Shqipëri;

b) përqindja e caktuar me dispozita të veçanta mbi të ardhurat që nxirren nga shërbimet gjyqësore;

c) çdo burim tjetër që nuk ndalohet me ligj.

Neni 5

Fondet në dispozicion të Zyrës përdoren për këto qëllime:

- a) Për pagat dhe sigurimet shoqërore të gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve dhe personelit administrativ të gjykatave.
- b) Për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të gjykatave, si dhe për veprimtari të tjera gjyqësore.
- c) Për ndëritmin ose meremetimin e godinave të gjykatave, si dhe për investime të tjera.
- ç) Për mbulimin e shpenzimeve të gjykatave, lidhur me dhënien e ndihmës së detyrueshme juridike në rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të veçanta.
- d) Për krijimin e fondit rezervë deri në 2 për qind të fondeve buxhetore të miratuara për gjykatat.

Neni 6

Zyra drejtohet nga një bord i përbërë nga:

- a) Kryetari i Gjykatës së Kasacionit.
 - b) Një anëtar i Gjykatës së Kasacionit, i zgjedhur nga mbledhja e gjyqtarëve të kësaj gjykate.
 - c) Dy kryetarë të gjykatave të apelit të zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e kryetarëve të gjykatave të apelit.
 - ç) Katër kryetarë të gjykatave të rretheve, të zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e kryetarëve të gjykatave të rretheve.
 - d) Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.
- Kryetari i bordit është kryetari i Gjykatës së Kasacionit. Zëvendëskryetari i bordit zgjidhet një prej anëtarëve të tij nga mbledhja e bordit për një periudhë dyvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.
- Anëtarët e bordit shpërblehen për pjesëmarrje në çdo mbledhje me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të gjykatës së rrethit të kategorisë së parë.

Neni 7

Anëtarët e bordit të përmendur në pikat b, c dhe c, të nenit 6 të këtij ligji zgjidhen përnjë periudhë dyvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Heqja nga bordi bëhet:

- a) kur anëtari jep dorëheqjen;
- b) kur është i paaftë fizikisht ose mendërisht;
- c) kur nuk ushtron funksionin e tij gjyqësor ose drejtues përshkak të të cilit është zgjedhur në këtë bord.

Neni 8

Mbledhja e bordit bëhet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të bordit. Vendimet merren me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave pro dhe kundër është i barabartë, vota e kryetarit të bordit është përcaktuese. Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbali nga një sekretar, jo anëtar i bordit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e bordit të pranishëm në mbledhje.

Neni 9

Detyrat e bordit janë:

- a) Miraton projektbuxhetin e paraqitur nga Zyra për çdo nivel të gjykatave dhe ia dergon atë për shqyrtim organit kompetent për miratimin e Buxhetit të Shtetit.
- b) Kontrollon përdorimin e fondeve të akorduara dhe analizon kërkesat e gjykatave për fonde që mund të lindin gjatë vitit buxhetor.
- c) Miraton transferimin e fondeve buxhetore brenda kompetencave që lejon ligji dhe përdorimin e fondit rezervë.
- ç) Emëron dhe shkarkon drejtorin e Zyrës. Emërimi i drejtorit të Zyrës bëhet me votim të fshehtë dhe me kandidatura alternative.
- d) Përcakton strukturën e Zyrës, si dhe numrin e personelit administrativ të saj dhe kriteret e emërimit të tyre.
- dh) Përcakton pagat e personelit të Zyrës në përputhje me kriteret e përgjithshme të caktimit të pagave për punonjësit e administratës.
- e) Miraton rregulloren e funksionimit të Zyrës.

Neni 10

Me miratim të kryetarit, në mbledhjet e bordit, ftohen të marrin pjesë specialistë të fushave të ndryshme.

Neni 11

Detyrat e drejtorit të Zyrës janë:

- a) Përfaqëson Zyrën përpara organeve shtetërore, institucioneve publike dhe të tretëve.
- b) Harton rregulloren e funksionimit të Zyrës dhe e paraqet për miratim në mbledhjen e bordit.
- c) Zbaton vendimet e marra në mbledhjen e bordit.
- ç) Përgatit projektbuxhetin dhe projektet e tjera ekonomike dhe i paraqet për shqyrtim e miratim në mbledhjen e bordit.
- d) I propozon bordit ndryshimin e destinacionit të fondeve nga një gjykatë në një gjykatë tjetër, si dhe përdorimin e fondit rezervë.
- dh) Emëron dhe shkarkon personelin administrativ të Zyrës sipas kriterëve dhe organikave të caktuara nga bordi.

Neni 12

Dispozitat e tjera ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2149, datë 9.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**